



# Raporti vjetor

## 2023

Përgatitur nga:  
**Instituti Riinvest**

Prill 2024

**Përgatitur nga:** Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest

**Publikuar nga:** RIINVEST INSTITUTE Lidhja e Prizrenit nr. 56 Prishtinë 10000, Republika e Kosovës  
Tel: + 381 (0)38 244320; 223816 [www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)

E drejta e autorit © 2024 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi, ose transmetohet, në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues apo ndryshe, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

## Përmbajtja

Hyrje .....	3
Për ne.....	5
1. Hartimi i dokumenteve udhëzuese për punën kërkimore të Institutit Riinvest dhe themelimi i këshillit shkencor .....	6
1.1. Programi i kërkimeve (2023-207).....	6
1.2. Programi për zhvillimin e personelit.....	6
1.3. Këshilli shkencor .....	7
2. Brendimi i produkteve kërkimore.....	7
2.1. Forumi Ekonomik Vjetor.....	7
2.2. Green 333 .....	8
2.3. Konferenca ndërkombëtare .....	8
3. Projektet .....	8
3.1. Instituti Riinvest, pjesë e programeve kornizë të BE-së .....	8
3.2. Transformimi i gjelbër (Green Action Space) .....	10
3.3. Pozita e ekonomisë së Kosovës në konkurrencën globale .....	11
3.4. Rrjeti rajonal i mjedisit biznesor lokal .....	12
3.5. Integriteti i sektorit privat: korrupsioni nga ana e ofertës: Financuar nga USAID KMI .....	13
3.6. Barometri i Prokurimit Publik – xIndex .....	13
3.7. Ekonomiksi i Mendimit Praktik mbështetur nga Iniciativa për Bazat Ekonomike.....	14
3.8. Vlerësimi i mbështetjes urgjente të transfertave të parave të gatshme të ofruara përmes skemës së ndihmës sociale në përgjigje të COVID-19 .....	15
3.9. Vlerësimi i varfërisë në Kosovë .....	15
3.10. Vlerësimi i informalitetit në Kosovë.....	15
4. Hulumtimet në terren .....	16
5. Zhvillimi i tregjeve .....	16
6. Informacione shtesë .....	17
6.1. Tryeza diskutimi.....	17
6.2. GREEN TALKS.....	17
6.3. Punëtori dhe trajnime .....	17
7. Pozita financiare (nxjerrë nga raporti i auditimit) .....	18
Shtojca 1. Indikatorët kryesorë të performancës (viti 2022-2023).....	19

## Hyrje

Të dashur lexues,

Me kënaqësi ju paraqesim raportin vjetor të Institutit Riinvest për vitin 2023. Ky raport përmbledh arritjet, sfidat dhe synimet e ardhshme të Institutit Riinvest në përmbushjen e misionit të tij për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës nëpërmjet dijeve të reja dhe studimeve cilësore.

Përgjatë vitit 2023, Instituti Riinvest ka zbatuar një numër domethënës të projekteve kërkimore dhe zhvillimore. Gjatë vitit 2023, Instituti Riinvest ka hartuar programin e tij kërkimor (2023-2027) i cili është aprovuar nga organet drejtuese të tij. Fushat prioritare të kërkimit ndërlidhen të parapara në këtë program janë: (i) rritja ekonomike dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe social; (ii) aftësia konkurruese e ekonomisë së Kosovës dhe sektorëve kyç të saj; (iii) konvergjenca ekonomike me BE, dhe Agjenda e BE-së për Ballkanin Perëndimor; dhe (iv) Mjedisi ekonomik dhe biznesor. Programi i kërkimeve për periudhën 2023-2027 paraqet një udhërrëfyes për Institutin Riinvest dhe bazë për udhëheqjen dhe administrimin e projekteve kërkimore. Programi përfshin orientimet strategjike dhe zbërthimin e tyre në shtylla programore, parakushtet financiare dhe burimet njerëzore dhe të tjera për realizimin e programit, bashkëpunimin ndërkombëtar, veprimtarinë botuese, dhe monitorimin e zbatimit.

3 Instituti Riinvest ka hartuar edhe programin për zhvillimin e personelit 2024-2027, bazuar në programin e kërkimeve 2023-2027 të Institutit Riinvest, dhe duke marrë parasysh orientimet dhe shtyllat strategjike të programit, kërkesat për zbatimin e programit dhe fushat dhe projektet specifike. Programi i zhvillimit të stafit është thelbësor për rritjen organizative, angazhimin dhe mbajtjen e stafit dhe ruajtjen e një avantazhi konkurrues. Hartimit të këtij programi i ka paraprirë një vlerësim i hendekut të shkathtësive që janë të nevojshme për Institutin Riinvest në realizimin e misionit të tij. Ky vlerësim ka orientuar propozimet për trajnime dhe zhvillim profesional për të kapërcyer hendekun e identifikuar. Programi është përgatitur nga menaxhmenti i lartë i institutit në bashkëpunim me stafin dhe bordin e Institutit Riinvest.

Gjithashtu, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e udhëzimit strategjik të kërkimeve tona, si dhe në proces të aplikimit për akreditim si institut kërkimor, Instituti Riinvest gjatë vitit 2023 ka krijuar një këshill shkencor i cili përbehet nga personalitete të shquara që vijnë nga bota akademike.

Krahas punës kërkimore dhe zbatimit të projekteve zhvillimore, Instituti Riinvest është angazhuar në mënyrë aktive me palë të ndryshme për të siguruar që rezultatet e punës sonë kërkimore përkthehen në zgjidhje të rëndësishme që adresojnë problemet reale të shoqërisë. Kemi vazhduar të ndërtojmë partneritete dhe bashkëpunime me institucione dhe organizata të tjera, lokale dhe globale, për të zgjeruar rrjetin tonë të kërkimit dhe ndikimin e punës sonë kërkimore.

Projektet në të cilat është përfshirë Instituti Riinvest ndërlidhen me fusha të ndryshme socio-ekonomike. Për qëllim të prezantimit më të lehtë për lexuesin, ky raport ka këtë përmbajtje: (i) 1. Hartimi i dokumenteve udhëzuese për punën kërkimore të Institutit Riinvest dhe themelimi i këshillit shkencor; (ii) brendimi i produkteve; (iii) projektet; (iv) hulumtimet në terren; (v) zhvillimi i tregjeve. Gjithashtu, raporti paraqet edhe (vi) informacione shtesë; dhe (vii) pozitën financiare në bazë të raportit të auditorit. Në shtojcë janë paraqitur indikatorët kryesorë në bazë të planit të veprimit.

Gjatë këtij viti, Instituti Riinvest ka rritur listën e bashkëpunëtorëve të jashtëm. Të hyrat nga projektet kanë qenë stabile. Këto të hyra janë siguruar nga donatorë, institucione tjera dhe sektor privat. Të gjitha fondet janë siguruar në baza konkurruese.

Instituti Riinvest mbetet i përkushtuar që të vazhdojë rrugën drejt përmbushjes së misionit të tij. Falënderojmë të gjithë partnerët për mbështetjen e vazhdueshme dhe presim me padurim të punojmë së bashku në vitin që vjen. Ju uroj lexim të këndshëm të këtij raporti vjetor.

Përzemërsisht,

Alban Hashani  
Drejtor Ekzekutiv

## Për ne

Instituti Riinvest është “think-tank” më i vjetër në Kosovë, duke vepruar që nga viti 1995. Misioni i Institutit Riinvest është ‘të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës nëpërmjet dijeve të reja dhe studimeve cilësore’. Instituti Riinvest është i angazhuar në katër fusha kryesore: a) hulumtime dhe avokim; b) zhvillim të tregjeve; c) trajnime dhe edukim; dhe d) hulumtime akademike.

Stafi i Institutit Riinvest përbëhet nga 19 punëtorë me orar të plotë dhe 3 me orar të pjesshëm. Prej tyre, 13 janë të angazhuar si hulumtues me orar të plotë (5 doktorë shkence; 4 magjistra shkence dhe 4 me titull bachelor). Instituti Riinvest ka dhe një rrjet prej 17 bashkëpunëtorëve shkencorë që angazhohen në kapacitete të ndryshme në aktivitetet e Institutit Riinvest (12 doktorë shkence; 2 studentë të doktoratës; 3 magjistër shkence). Bordi i Institutit Riinvest përbëhet nga shtatë (7) anëtarë: z. Sejdi Osmani, kryesues dhe anëtarët: Dr. Selman Selmanaj, Dr. Valentin Toçi, Dr. Gresa Latifi, MSc. Mimoza Godanci, Dr. Petrit Gashi, dhe Dr. Isuf Berisha.

Vizioni i Institutit Riinvest për periudhën 2030/2035 është që ...’Si lider i studimeve zhvillimore në vend, Instituti Riinvest ka arritur që nëpërmjet partneritetit me institutet me renome në BE e më gjerë të realizojë projekte të standardeve të larta ndërkombëtare duke internacionalizuar produktet dhe shërbimet e tij në fushën e studimeve, edukimit dhe promovimit të diturive të reja’...

Duke synuar përmbushjen e misionit dhe arritjen e vizionit, objektivat strategjike të Institutit Riinvest për periudhën 2022 -2027 janë:

- Ngritja e mëtejme e kapaciteteve strategjike, profilit kërkimor dhe aftësive konkurruese të Institutit Riinvest dhe stafit të tij për të trajtuar problemet kyçe dhe prioritare të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e social sipas kërkesave dhe standardeve Evropiane;
- Ndërtimi i aleancave dhe partneritetit strategjik me organizatat hulumtuese dhe think tank në BE e më gjerë, depërtimi suksesshëm në financimin e projekteve nga Programet Kornizë të Bashkimit Evropian dhe internacionalizimi i produkteve dhe shërbimeve;
- Forcimi i qëndrueshmërisë financiare dhe rritja e të ardhurave vjetore për së paku 70% dhe diversifikimi i burimeve të të ardhurave;
- Brendim i së paku 2-3 produkteve;
- Ngritja e cilësisë së marrëdhënieve me publikun, përmirësimi i komunikimit, rritja e prezencës në media.

## 1. Hartimi i dokumenteve udhëzuese për punën kërkimore të Institutit Riinvest dhe themelimi i këshillit shkencor

### 1.1. Programi i kërkimeve (2023-2027)

Gjatë vitit 2023, Instituti Riinvest ka hartuar Programin e Kërkimeve për periudhën 2023-2027, i cili paraqet një udhërrëfyes dhe bazë për udhëheqjen dhe administrimin e projekteve kërkimore. Duke u bazuar në Planin Strategjik 2022-2027 të aprovuar nga Bordi i Institutit Riinvest, Programi përcakton shtyllat programore të kërkimeve dhe zbrërthimin e tyre në fusha dhe projekte kërkimore. Programi udhëhiqet dhe bazohet gjithashtu nga misioni dhe vizioni i Institutit të përkufizuara në Planin Strategjik. Në kuadër të përgatitjes së këtij Programi janë zhvilluar diskutime me stafin dhe partnerët tanë në aspektin e pritjeve të tyre si dhe është analizuar draf Programi Kombëtar i Kërkimeve Shkencore, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030, Programi i Reformave Ekonomike i Qeverisë së Kosovës, Strategjia për zhvillim industrial dhe mbështetje të bizneseve 2030, draft Strategjia e Specializimit të Mençur (S3), si dhe një serë strategjish sektoriale të aprovuara nga institucionet e vendit. Vëmendje e posaçme i është kushtuar analizës së orientimeve strategjike lidhur me prioritetet e Hapësirës Evropiane të Kërkimeve (ERA) dhe orientimeve programore të programeve kornizë (FP) të Komisionit Evropian e në veçanti orientimeve programore të Horizon Europe 2021-2027. Gjithashtu janë analizuar edhe strategjitë dhe orientimet programore të partnerëve tanë afatgjatë si Banka Botërore, USAID, BE, SDC, GIZ, SIDA dhe UNDP.

### 1.2. Programi për zhvillimin e personelit

Instituti Riinvest ka hartuar Programin për Zhvillimin e Personelit 2024-2027, bazuar në Programin e Kërkimeve 2023-2027 të Institutit Riinvest, dhe duke marrë parasysh orientimet dhe shtyllat strategjike të programit, kërkesat për zbatimin e programit dhe fushat dhe projektet specifike. Programi i zhvillimit të stafit është thelbësor për rritjen organizative, angazhimin dhe mbajtjen e stafit dhe ruajtjen e një avantazhi konkurrues.

Hartimit të këtij programi i ka paraprirë një vlerësim i hendekut të shkathtësive që janë të nevojshme për Institutin Riinvest në realizimin e misionit të tij. Ky vlerësim ka orientuar propozimet për trajnime dhe zhvillim profesional për të kapërcyer hendekun e identifikuar. Programi është përgatitur nga menaxhmenti i lartë i institutit në bashkëpunim me stafin dhe bordin e Institutit Riinvest.

Ekipi i tanishëm, përfshirë bashkëpunëtorët, kanë njohuri të shquara në fusha të ndryshme që lidhen me punën kërkimore të Institutit Riinvest. Megjithatë, në bazë të vlerësimeve janë evidentuar nevoja për ngritjen e kapaciteteve, në disa fusha, përfshirë: (i) prognoza ekonomike; (ii) mediat sociale dhe komunikim; (iii) vizualizim të të dhënave; (iv) hartim dhe menaxhim të projekteve; si dhe (v) trajnime për fushat tematike që mbulon Instituti Riinvest (konkurrueshmëria; tranzicioni i gjelbër; tranzicioni digjital).

Përballë këtij sfondi, programi parasheh që të organizohen trajnime dhe punëtori që do të jenë të obligueshme për një pjesë apo gjithë stafin dhe do të ofrohen qoftë brenda institutit Riinvest apo do të kontraktohen nga partnerë të jashtëm.



### 1.3. Këshilli shkencor

Në bazë të ligjit për Aktivitete Kërkimore dhe Shkencore të Republikës së Kosovës, institutet kërkimore, krahas organeve tjera udhëheqëse, duhet të kenë edhe Këshillin Shkencor. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e udhëzimit strategjik të kërkimeve tona, si dhe në proces të aplikimit për akreditim si institut kërkimor, Instituti Riinvest gjatë vitit 2023 ka krijuar një Këshill Shkencor i cili përbehet nga personalitete të shquara që vijnë nga bota akademike. Me vendim të Bordit të Institutit Riinvest gjatë vitit 2023, është themeluar Këshilli Shkencor i përbërë nga 5 anëtarë (përfshirë kryesuesin), me mandat 4 vjeçar. Këshilli shkencor ka këtë përbërje, Dr. Alban Hashani (kryesues), dhe anëtarët: Dr. Muhamet Mustafa, Dr. Besnik Krasniqi, Dr. Venera Demukaj dhe Dr. Iraj Hashi. Këshilli shkencor, sipas vendimit, mbledhet dy herë në vit.


## 2. Brendimi i produkteve kërkimore

Për ta forcur rolin e tij si “think-tank”, Instituti Riinvest në planin strategjik për periudhën 2022-2027 ka parapara edhe brendimin e disa produkteve që në intervale të rregullta kohore pasqyrojnë arritjet e tij në kërkime dhe në situatën sociale dhe ekonomike në vend. Këto produkte, sipas dizajnit, duhet të kenë dinamikën e rregullt dhe formatin e tyre, përdërisa struktura dhe përmbajtja avancojnë në pajtim me zhvillimet e arritjet e reja.



### 2.1. Forumi Ekonomik Vjetor

Gjatë vitit 2023, Instituti Riinvest ka lansuar “Forum Ekonomik Vjetor” i cili do të jetë një tubim tradicional vjetor që mbahet në nëntor, për një diskutim të angazhuar lidhur me ecuritë ekonomike brenda vitit aktual, pritjeve për vitin vijues (duke përfshirë edhe propozimet për buxhetin e ri), si dhe vlerësime dhe rekomandime lidhur me avancimin e politikave zhvillimore. Këtij forumi gjithmonë i paraprin një studim i cili ka tre pjesë: (i) ecuritë ekonomike në vend; (ii) mjedisin biznesor; përdërisa tema e tretë ndryshon çdo vit. Gjatë



vitet 2023, tema bosht e Forumit ka qenë në lidhje me zhvillimet në tregun e punës dhe problemi i migrimit të fuqisë punëtore. Ky studim është titulluar “Një model i ri për ritje



të qëndrueshme ekonomike (dinamikat e tregut të punës: sfidat aktuale dhe të ardhshme)”. Viteve të ardhshme, Forumi do të jetë dy ditor ku në ditën e dytë do të prezantohen punime kërkimore në format akademik lidhur me temat bosht.

## 2.2. **Green 333**

Gjatë vitit 2023, gjithashtu është konceptuar modeli i video-prezantimeve ‘Green 333’. Ky model përfshin mesazhe të shkurta nga tre personalitete, ku secili brenda një minute prezantojnë tre çështje të ndryshme që lidhen me një temë bosht. Për këtë qëllim, ka filluar një program i ngritjes së kapaciteteve, dhe gjatë vitit 2024, këto video-prezantime do të mund të prodhohen nga stafi i brendshëm i Institutit Riinvest.

## 2.3. **Konferenca ndërkombëtare**

Instituti Riinvest gjithashtu ka paraparë organizimin e konferencës tradicionale ndërkombëtare. Kjo konferencë me titull punues “Aktivizimi i burimeve të rritjes ekonomike” do të organizohet çdo dy vjet. Konferenca e radhës do të mbahet në vitin 2025 për të shënuar 30 vjetorin e themelimit të Institutit Riinvest. Konferenca do të sigurojë pjesëmarrje të punëtorëve akademikë e kërkimorë nga BE, SHBA, MB, rajoni, si dhe nga institucionet vendore e ndërkombëtare.

## 3. **Projektet**

### 3.1. **Instituti Riinvest, pjesë e programeve kornizë të BE-së**

Instituti Riinvest, në kuadër të një konsorciumi të gjerë me organizata kërkimore nga Austria, Gjermania, Italia, Kroacia dhe nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor ka filluar zbatimin e projektit “Mbështetje për avancimin e politikave të hulumtimit dhe inovacionit në shtetet e Ballkanit perëndimor” (me shkurtesë në anglisht, “Policy Answers”). Ky është një projekt katër vjeçar i udhëhequr nga ZSI (Qendra për Inovacione Sociale) nga Vjena. Përveç kontributit në gjithë pakot punuese të projektit Riinvest është udhëheqës i pakos së punës “Mbështetje për ndërtim të kapaciteteve dhe zbatim të projektit në Kosovë”. Projekti financohet nga fondet e HORIZON Europe (WIDERA-2021-ACCESS-06-01).



Synimi kryesor i projektit është të monitoroj dhe mbështesë koordinimin e politikave për forcimin e bashkëpunimit të Bashkimit Evropian (BE) dhe shteteve të Ballkanit perëndimor (BP) si dhe të mbështesë forcimin e potencialit të vendeve të BP-së për pjesëmarrje të suksesshme në aktivitetet kërkimore dhe inovative rajonale dhe shumëpalëshe, për të promovuar bashkëpunimin rajonal në kërkime dhe inovacion dhe për të mbështetur rrjetëzimin dhe qasjen në informacion dhe përsosmëri. Fokus tematik i projektit është zbatimi i Agjendës së Gjelbër dhe Transformimit Digjital, përmirësimi i shëndetësisë dhe aspekteve gjinore.

‘Policy Answers’ ka këto objektiva që synon t’i arrij përmes aktiviteteve të projektit:

- Organizimi i ngjarjeve të dialogut për politikave publike (përfshirë takimet e Ministrave dhe Platformës Drejtuese; takime ad-hoc koordinuese të politikave publike), duke ofruar hapësirë për shkëmbim rreth zbatim të politikave (të pasqyruara në Pakon e Punës 1).
- Kryerja e aktiviteteve analitike si skanimi dhe kadastrimi i institucioneve, programeve, nismave, nevojave dhe prioriteteve të përbashkëta në BP; monitorimin e aktiviteteve të vazhdueshme në nivele të ndryshme në lidhje me zbatimin e Agjendës së BP-së dhe me progresin e bërë në lidhje me integrimin në hapësirën kërkimore evropiane; ofrimin e rekomandimeve strategjike të informuara për politikëbërjen dhe përcaktimin e agjendës (të pasqyruara në Pakon e Punës 2).
- Sigurimi dhe koordinimi i ngritjes së kapaciteteve dhe pilot-projekteve në BP për të kontribuar në procesin e integritit të rajonit në BE dhe për të forcuar ekosistemet e tyre të inovacionit (pasqyruar në Pakon e Punës 3).
- Hartimi i rekomandimeve të politikave të informuara për vendimmarrësit në rajon në fushat e hulumtimit dhe inovacionit, arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit në adresimin e prioriteteve kyçe të BE-së: (1) dixhitalizimi, (2) ekonomia e gjelbër dhe (3) shëndeti dhe përafrimi i tyre (pasqyruar në Pakon e Punës 4).
- Zbatimi i pilot-aktiviteteve rajonale, të cilat shtrihen drejtpërdrejt në akademinë, industrinë dhe shoqërinë civile; krijimi i nismave të reja dhe fillimi i historive të suksesit në nivel programi (pasqyruara në Pakon e Punës 5).
- Furnizimi i një qendre informacioni dhe një ueb-platforme që adreson hulumtimin dhe inovacionet, arsimin, kulturën, rininë dhe sportin në BP për të mundësuar këmbim dhe shpërndarje më të mirë të informacionit, krijimin e mundësive për veprime të përbashkëta dhe përafrimin e vendeve të BP-së në politikëbërjen e BE-së (pasqyruar në Pakon e Punës 6).
- Këto aktivitete të projektit mbështeten nga një koordinim efektive duke përfshirë menaxhimin e plotë administrativ dhe financiar dhe ndërlidhjen e ngushtë me Komision Evropian, Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe palët e tjera të interesuara të ftuar në një Bord Këshillimor të Projektit ose si partnerë bashkëpunëtorë (Plani i Punës 7).



Instituti Riinvest ka krijuar sinergji ndërmjet projekteve në kuadër të ‘Policy Answers’ dhe projekteve tjera.

### 3.2. Transformimi i gjelbër (Green Action Space)

Në kuadër të aktiviteteve të tij, Instituti Riinvest gjatë vitit 2023 ka vijuar punën në kuadër të programit të lidhur me transformimin e gjelbër. Bashkimi Evropian përmes Marrëveshjes së Gjelbër synon që deri në vitin 2050 ta bëjë Evropën rajon me zero emetim të karbonit. Në këtë kontekst, dhe me iniciativën e BE-së, edhe Ballkani Perëndimor (BP) po bën përpjekje që të jetë kontribuues aktiv në këto iniciativa. Agjenda e Gjelbër e BP-së, që është edhe zotim zyrtar i këtyre vendeve, synon që përmes zbatimit të një sërë masash dhe koordinimit me BE-në të reformojë sektorin energjetik, eliminoj ndotjen, dekarbonizojë ekonominë, ruaj biodiversitetin, dhe promovojë ekonominë qarkore. Përballë këtij sfondi, përpjekjet tona në Institutin Riinvest ishin që të kontribuojmë në ngritjen e vetëdijes dhe cilësisë së diskutimit lidhur me këto çështje dhe të promovojmë politikë bërjen e bazuar në evidencë.

Në këtë kontekst Instituti Riinvest ka vijuar punën në kuadër të platformës të titulluar GAS (ang. Green Action Space; Hapësira për Veprim të Gjelbër). Në kuadër të GAS janë paraparë tre shtylla: (i) shkolla e gjelbër; (ii) kërkimet; dhe (iii) avokimi. Gjatë vitit 2023, Instituti Riinvest ka formësuar GAS-in si një qendër me identitet vizual të saj dhe hapësirë e infrastrukturë adekuate për këtë qëllim. Gjithashtu, GAS ka faqen e saj zyrtare në rrjetet sociale ku ka mijëra ndjekës.

Gjatë vitit 2023, Instituti Riinvest ka finalizuar ciklin e dytë të shkollës së gjelbër. Një cikël ka gjithsej 12 ligjërata dhe dy punëtori jashtë vendit, brenda 14 javëve. Interesimi i kandidatëve për të marrë pjesë në shkollë ka qenë shumë i madh dhe përbërja e klasës së parë të shkollës ka qenë në linjë me synimet tona fillestare. Kjo shkollë ka për qëllim parësor që të rrisë vetëdijen dhe pajis me njohuri përfaqësuesit e shoqërisë civile, politikbërësve, dhe bizneseve, lidhur me çështjet mjedisore duke inkurajuar debatin dhe avokimin në kontekst të Agjendës së Gjelbër. Shkolla e gjelbër ka një format edukativ ku përfshihen ligjërata, punëtori tematike, diskutime, dhe tryeza. Për më tepër, shkolla gjithashtu ka nxitur diskutime dhe debate në mes të palëve të ndryshme të interesit lidhur me sfidat dhe implikimet që rrjedhin nga zotimet e Qeverisë së Kosovës lidhur me Agjendën e Gjelbër.





Në kuadër të projektit "Policy Answers" si dhe platformës Green Action Space gjatë vitit 2023 është mbajtur diskutimi-punëtorja me temën 'Agjenda e Gjelbër e Ballkanit Perëndimor: Kapacitetet institucionale dhe krijimi i sinergjive për implementim të sukseshëm të zotimeve karshi marrëveshjes'. Hulumtues nga Instituti Riinvest, përfaqësues nga ministritë relevante


shtetërore, shoqëria civile si dhe ekspertë të pavarur dhe media, prezantuan arritjet në rrugën që kemi përpara për të vënë në jetë zotimet shumë kërkuese nga Agjenda e Gjelbër e mbështetur e fuqizuar nga Bashkimi Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Gjithashtu, në kuadër të GAS organizohen aktivitete të rregullta avokuese "Green Talks" që kanë për qëllim informimin e politikave publike përmes diskutimeve dhe debateve të mirë informuara, si dhe analizave tematike për ndikimin socio-ekonomik të zotimeve që dalin nga Agjenda e Gjelbër e Ballkanit Perëndimor.

Gjatë vitit 2023 janë organizuar 2 debate në lidhje me temat në vijim:

1. Burimet ujore në Kosovë
2. Dekarbonizimi

Nga të gjitha këto takime janë hartuar punime të shkurtra (Policy Briefs) të cilat janë shpërndarë tek politikëbërësit dhe palët tjera të interesit.




### 3.3. Pozita e ekonomisë së Kosovës në konkurrencën globale

Projekti ka synuar të krijojë një qasje të integruar të masave në fushën e politikëbërjes për promovimin e inovacionit dhe rritjen e konkurrueshmërisë së Kosovës. Projekti ka ofruar të dhëna, mjete analitike dhe tregues për të krahasuar nivelin e konkurrueshmërisë së Kosovës me vendet e tjera të paraqitura në Raportin e Konkurrueshmërisë Globale të Forumit Ekonomik Botëror.



Objektivat e projektit kanë qenë: (i) Përmirësimi i informacionit në lidhje me nivelin e konkurrueshmërisë së Kosovës, (ii) Gjenerimi i indeksit të konkurrueshmërisë së Kosovës dhe krahasimi i tij me vendet tjera, (iii) Propozimi i rekomandimeve të masave dhe politikave për zhvillimin e konkurrueshmërisë së Kosovës. Ky studim përdor një metodologji të bazuar në Raportin e Konkurrueshmërisë Globale që është anketa më afatgjate dhe më e gjerë e këtij lloji që ofron një vlerësim vjetor të aspekteve kritike të konkurrueshmërisë. Ky studim është mbështetur e hartuar në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.



### 3.4. Rrjeti rajonal i mjedisit biznesor lokal

Programin e Certifikimit të Komunave Miqësore për Biznesin (ang. Business Friendly Certification - BFC) është një iniciativë rajonale dhe synon të vlerësoj mjedisin biznesor lokal udhëhequr nga praktikatat më të mira të qeverisjes vendore nga e gjithë bota. Me mbështetje të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) - Fondi i Hapur Rajonal për Modernizimin e Shërbimeve Komunale ky program u bë një standard rajonal për mjedisin e biznesit i cili u pranua nga institucionet partnere nga rajoni me synimin për të vendosur vulën e biznesit në cilësinë e mjedisit afarist në komunat dhe qytetet e Evropës Juglindore (EJL). Në këtë projekt Instituti Riinvest shërben si sekretariat për Kosovë. Faza e parë e projektit realizohet në periudhën 2022-2024, me pjesëmarrjen e komunave Kosova.



Certifikimi i Komunave Miqësore të Biznesit në Evropën Juglindore (BFC SEE) është një program i veçantë i përmirësimit dhe harmonizimit të mjedisit për të bërë biznes, duke inkurajuar bashkëpunimin ekonomik dhe duke tërhequr investime të reja në rajonin e Evropës Juglindore. Vula e cilësisë së BFC SEE është njohur në sferën ndërkombëtare si një tregues i administratës lokale efikase dhe mjedisit miqësor ndaj

investimeve në Evropën Juglindore. Gjatë vitit 2023, Instituti Riinvest ka filluar procesin e certifikimit të 5 komunave në Kosovë (Prishtina, Prizreni, Peja, Kamenica, dhe Lipjani). Në kuadër të këtij projekti, stafi i Institutit Riinvest ka marrë pjesë në konferencën rajonale në Kotor dedikuar konkurrueshmërisë dhe mjedisit biznesor në rajonin e Ballkanit Perëndimor titulluar 'Growing Smart and Green'. Gjithashtu, janë trajnuar si certifikues dhe vlerësues 4 hulumtues të Institutit Riinvest dhe 3 konsulentë të jashtëm.


### 3.5. Integriteti i sektorit privat: korrupsioni nga ana e ofertës: Financuar nga USAID KMI

Objektivi i përgjithshëm është ngritja e vetëdijes dhe mobilizimi i aktorëve kryesorë brenda komunitetit të biznesit në Kosovë në zhvillimin e parimeve etike dhe ngritjen e integritetit të sektorit privat për të reduktuar korrupsionin, pra duke trajtuar anën e ofertës së korrupsionit. Projekti ka për qëllim të identifikojë qëndrimet e bizneseve dhe drejtuesve të biznesit lidhur me këtë çështje. Aktivitetet kryesore të projektit janë; (i) Kryerja e një studimi bazë mbi integritetin e sektorit privat (ii) Fillimi i fushatave ndërgjegjësuere që synojnë komunitetin e biznesit, duke theksuar rëndësinë e integritetit dhe praktikave etike, (iii) Nënshkrimi i Kodit Kundër Korrupsionit nga asociacionet e biznesit (iv) Krijimi i një Komiteti Drejtues (v) Ofrimi i trajnime dhe mbështetje për asociacionet e biznesit.

### 3.6. Barometri i Prokurimit Publik – xIndex

'Barometri i Prokurimit Publik – xIndex' synon të përmirësojë transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e 38 komunave të Kosovës në prokurimin publik. Qëllimi afatgjatë i projektit është krijimi i një modeli të qëndrueshëm, ose një mjeti krahasues të cilit do t'i referohen komunitat, si dhe institucionet kryesore të prokurimit, OJQ-të dhe palët e tjera të interesit. Modeli statistikor 'xIndex' mbështetet në të dhëna sasiore, të publikuara nga vetë komunitat në platformën 'e-prokurimi', duke mos lënë hapësirë për interpretim subjektiv të gjetjeve.

Metodologjia e 'x-index' mbështetet në një metodologji tashmë të konsoliduar dhe të kontekstualizuar nga stafi i Institutit Riinvest që t'i përbrendësojë specifikat e Kosovës. Metodologjia vlerësuese bazohet në nëntë nën-indekse të monitorimit, ku secili prej tyre përshkruan një çështje të veçantë të prokurimit publik. Në fund, rezultatet e 9 nën-indekseve kombinohen për të prodhuar një vlerë të vetme të x-indeksit, duke përdorur një mesatare të ponderuar, për çdo komunë.



Instituti Riinvest ka vijuar të grumbulloj të dhënat për të gjeneruar indeksin e prokurimit publik si dhe ka vizualizuar të dhënat në një platformë të re të dizajnuar nga stafi i Institutit Riinvest. E njëjta platformë është integruar në webfaqen e Institutit Riinvest.

### 3.7. **Ekonomiksi i Mendimit Praktik mbështetur nga Iniciativa për Bazat Ekonomike**

Qëllimi kryesor i projektit është të ndihmojë në ngritjen e standardeve të arsimit ekonomik në rajonet e Evropës Lindore dhe Juglindore dhe ish-Bashkimit Sovjetik duke promovuar dhe shpërndarë për lexuesit pa pagesë në të gjitha formatet edicionit të të librit Ekonomiksi i Mendimit Praktik, përgatitur nga Iniciativa e Bazave Ekonomike (në tekstin e mëtejshëm “EFI”), për audiencën më të gjerë të mundshme. Për këtë qëllim, EFI do të punojë me partnerët në vendet e synuara për të maksimizuar ndikimin e projektit, duke shfrytëzuar ekspertizën e partnerëve në ofrimin e projekteve arsimore dhe të kuptuarit e tyre për mjedisin operativ lokal. Në kuadër të këtij projekti janë organizuar një seri aktivitesh:

**Olimpiada e Ekonomiksit:** Në këtë olimpiadë marrin pjesë nxënës të shkollave të mesme në Kosovë dhe përbëhet nga 3 raunde - shkollore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Fillimisht, studentët i nënshtrohen një testi në internet dhe studentët të cilët performojnë më mirë kalojnë në raundin tjetër. Në raundin e dytë, 50 konkurrentët më të mirë nga Kosova garojnë në mes vete. Gjatë vitit 2023, 5 studentët më të mirë kanë udhëtuar në Bratislavë, Sllovakia. Ky aktivitet vijon edhe në vitet tjera.



**Punëtorja me gazetarë:** Ne fund të vitit 2023 është organizuar punëtorja për gazetarë “Parimet bazë në gazetarinë ekonomike”. Gazetarët e mediave me më ndikim në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut janë ftuar që të marrin pjesë në këtë seminar dy ditor të organizuar nga Instituti Riinvest, me trajnerë nga fusha e gazetarisë e ekonomisë.

**Kampanja në rrjetet sociale:** Komunikimi ynë në rrjetet sociale do të vazhdojë të jetë kanali kryesor i ndërveprimit, informacionit publik, njoftimeve dhe marketingut të ngjarjeve në të gjitha aktivitetet e projektit.





### **3.8. Vlerësimi i mbështetjes urgjente të transfertave të parave të gatshme të ofruara përmes skemës së ndihmës sociale në përgjigje të COVID-19**

Qëllimi i këtij studimi ishte hartimi i një vlerësimi të shpejtë nëpërmjet një ankete me 1,000 familje që kanë marrë ose aplikuar në njërin nga dy programet e Skemës së Asistencës Sociale (SAS) ose Masa 15 e cila ka dalur nga pakoja emergjente e qeverisë për të ndihmuar familjet gjatë pandemisë. Ky studim ka pasur dy objektiva kryesore (i) eksplorimin e ndikimeve të masave të kontrollit të COVID-19 në familjet e varfra dhe të cenueshme; dhe, (ii) vlerësimin e përvojës së përfituesve në (ri) aplikimin e tyre në SAS dhe Masën 15, dhe ato të përfituesve në lidhje me pagesën. Projekti është financuar nga Banka Botërore ndërsa është zbatuar nga Ministria e Shëndetësisë.

### **3.9. Vlerësimi i varfërisë në Kosovë**

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti ishte t'i ofrojë grupit të Bankës Botërore informacion dhe të dhëna për disa çështje që lidhen me situatën ekonomike në Kosovë. Stafi i Riinvest ka punuar në katër dokumente të shkurtra që lidhen me (i) fuqizimin ekonomik të grave (ii) sektorin digjital si një mundësi për tranzicionin e gjelbër (iii) informalitetin në Kosovë dhe (iv) tregu i punës për të rinjtë në Kosovë. Projekti është financuar nga Banka Botërore dhe do të jetë pjesë e studimit të saj lidhur me vlerësimin e varfërisë në Kosovë.

### **3.10. Vlerësimi i informalitetit në Kosovë**

Qëllimi i këtij projekti ishte të ndihmojë një bankë komerciale në vlerësimin real të informalitetit në Kosovë, me qëllim që të përmirësoj procesin e kreditimit të bizneseve. Objektivat kryesore të projektit ishin: (i) vlerësimi i informalitetit tek bizneset mikro dhe të vogla (ii) identifikimi i një standardi gjithëpërfshirës të pasqyrave financiare që përdoren zakonisht nga bankat për qëllime të shqyrtimit të kredive (iii) të kuptuarit e nivelit të të hyrave të deklaruara dhe marrjen e rekomandimeve për zhvillimin e një model të përshtatshëm që merr parasysh të ardhurat reale në procesin e shqyrtimit të kredive. Për të arritur këto objektivat Riinvest ka ndërmarr disa aktivitetet (i) ka kryer një anketë më 1,200 biznese në sektorë të ndryshëm në nivel të Kosovës. (ii) ka intervistuar menaxherë të riskut në bankat komerciale në Kosovë dhe (iii) ka hulumtuar praktikrat rajonale dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

## 4. Hulumtimet në terren

Në përgjithësi janë realizuar këto hulumtime në terren, si pjesë edhe e projekteve të cituara në këtë raport:

<b>Emri i projektit:</b>	<b>Integriteti i sektorit privat: korrupsioni nga ana e ofertës</b>
Donatori:	USAID - DAI
Data e implementimit:	Dhjetor 2023
Madhësia e mostrës:	500 biznese
<b>Emri i projektit:</b>	<b>Vlerësimi i informalitetit në Kosovë</b>
Donatori:	Bankë komerciale
Data e implementimit:	Gusht-Shtator 2023
Madhësia e mostrës:	1,200 biznese
<b>Emri i projektit:</b>	<b>Vlerësimi i masave të rimëkëmbjes pas COVID-19 (transferet emergjente)</b>
Donatori:	Banka Botërore dhe Ministria e Shëndetësisë
Data e implementimit:	Qershor-Gusht 2023
Madhësia e mostrës:	1000 respondentë
<b>Emri i projektit:</b>	<b>Anketa e turizmit 2023</b>
Donatori:	PPSE
Data e implementimit:	Korrik-Gusht 2023
Madhësia e mostrës:	550 respondentë
<b>Emri i projektit:</b>	<b>Pozita e Kosovës në konkurrencën globale</b>
Donatori:	ASHAK
Data e implementimit:	Maj 2023
Madhësia e mostrës:	500 respondentë

Gjithashtu, janë realizuar dhjetëra intervista të thelluara me ekspertë të fushave të ndryshme dhe janë organizuar disa grupe të fokusit.

## 5. Zhvillimi i tregjeve

Instituti Riinvest është bashkë zbatues i projektit Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) së bashku me SwissContact nga Zvicra. Qëllimi i përgjithshëm i projektit PPSE-së në Kosovë është të fasilitojë funksionimin e NMV-ve dhe fermave që janë në rritje dhe të qëndrueshme në sektorët e ushqimit dhe përbërësve natyralë dhe të turizmit, që ofrojnë mundësi për punë të denjë dhe për të ardhura për gratë dhe burrat në Kosovë. Projekti fokusohet në dy sektorë kryesorë: Ushqimi dhe Përbërësit Natyralë dhe Turizmi.

Përmes temave ndërsektoriale të qeverisjes, barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirës sociale, projekti fasiliton dialogun dhe shërbime këshillimore për aktorët e zinxhirit të vlerave, ndërkohë që eksploron mundësi për angazhimin e grave dhe minoriteteve në përputhje me nevojat e tyre. Mbi bazën e rezultateve dhe mësimëve të nxjerra gjatë Fazës II (2017 - 2021) të projektit, Faza III i qaset zhvillimit të sektorit privat dhe krijimit të vendeve të punës duke e vënë më shumë theksin tek rinia, gratë dhe minoritetet. Financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

## 6. Informacione shtesë

### 6.1. Tryeza diskutimi

1. Vendimmarrja e grave në sektorin publik dhe privat (prezantimi në Qeverinë e Kosovës, mbështetur nga Agjencia për Barazi Gjinore) - Janar 2023
2. Strategjia për zhvillimin Industrial dhe mbështetja e bizneseve 2030 - Prill 2023
3. Diskutimi i draft programit të shkencës 2023-2028 - Prill 2023
4. Korniza Institucionale dhe rregullative për rritjen e burimeve dhe administrimit të financave të kërkimeve dhe inovacioneve në Kosovë - May 2023
5. Forumi Ekonomik Vjetor – Një model i ri për rritjen e qëndrueshme ekonomike – Nëntor 2023

### 6.2. GREEN TALKS

6. Burimet Ujore në Kosovë – 26 janar 2023
7. Dekarbonizimi dhe taksa e karbonit, 7 Maj 2023

### 6.3. Punëtori dhe trajnime

8. Trajnimi për përgatitjen e aplikimeve për Horizon Europe
  - a. shkurt 2023 dhe
  - b. prill – maj 2023
9. Prezantimi i punimeve të përgatitura gjatë trajnimeve – Maj 2023
10. Agjenda e gjelbër e Ballkanit Perëndimor - Maj 2023
11. Forumi i palëve të interesit – Nëntor 2023
12. Trajnimi me gazetarë nga Kosova, Maqedonia Veriore dhe Shqipëria - Dhjetor 2023

Krahas këtyre aktiviteteve, stafi i Institutit Riinvest ka marrë pjesë edhe në dhjetëra tryeza e konferenca të organizuara nga institucione tjera.

## 7. Pozita financiare (nxjerrë nga raporti i auditimit)

<b>Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	<b>2023 (€)</b>	<b>2022 (€)</b>
<b>Të hyrat</b>	495,136*	370,643*
<b>Kostoja e shitjes</b>		(306)
<b>Total</b>	<b>495,136</b>	<b>370,337</b>
<b>Të ardhurat tjera</b>		
<b>Shpenzimet e shpërndarjes</b>	(104,513)	(85,825)
<b>Shpenzimet administrative</b>	(350,782)	(281,179)
<b>Shpenzimet e tjera</b>	(3,841)	(3,333)
<b>Fitimi / (humbja) operativ</b>	0.00	0.00

\*Në linjë me standardet e raportimit, këtu nuk përfshihen të hyrat e shtyra nga viti në vit.

## Shtojca 1. Indikatorët kryesorë të performancës (viti 2022-2023)

\*aktivitetet e hijezuara me te kuqe nuk janë përbushur sipas planit

Objekтиви:	Aktivitetet	Vlera fillestare	Caku	Gjendja aktuale	Indikatorit	Shënim
Objekтиви 1. Ngritja e mëtejme e kapaciteteve strategjike, profilit kërkimor dhe aftësi konkurrese të Institutit Rinvest dhe stafit të tij për të trajtuar problemet kyçe dhe prioritare të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e social sipas kërkesave dhe standardeve Evropiane.	Rekrutimi i stafit me orar të plotë	11	17	17	Numri i personave të rekrutuar	- 1 hulumtues është në vijim e sipër të studimeve pas-diplomike jashtë vendit
	Rekrutimi i stafit me orar të pjesshëm/bashkëpunëtorët	15	18	18	Numri i bashkëpunëtorëve të angazhuar	-
	<b>Mobiliteti i stafit</b>	-	<b>3</b>	-	<b>Numri i stafit që delegohet në iniciativa këmbimi</b>	-
	Trajnimet e stafit të brendshëm	ad hoc	3	3	Programi i trajnimeve dhe evidenca e trajnimeve	- Hartimi i projekt propozimeve (2) - Trajnim për Qualtrics (1)
	Produksioni kërkimor	-	15	16	Raportet e publikuara	-raporte; shkurtimisht për
	Dixhitalizimi i procesit të grumbullimit të të dhënave cilësore	-	1	1	Parapagimi për Qualtrics	-
	Dixhitalizimi i proceseve administrative	-	1	1	Parapagimi për EmDesk	Përdorimi i veglave tjera të MS Office
	<b>Skemë mbështetëse që do të stimuloj publikimin e artikujve në revista shkencore</b>	-	<b>1</b>	-	<b>Skema mbështetëse</b>	<b>*gjatë vitit 2024</b>
Objekтиви 2. Ndërtimi i aleancave dhe partneritetit	Konsolidimi i marrëdhënieve me partnerë	-	2	2	Numri i aplikimeve	1 HE; 1 Erasmus+
	Takime formale me partnerë	ad hoc	15	20	Përmbledhje nga takimet	Takime me donatorë në Kosovë dhe Evropë

Objektivi 3. Forcimi i qëndrueshmërisë financiare dhe rritja e të ardhurave vjetore për së paku 70% dhe diversifikimi i burimeve të të ardhurave	<b>Të hyrat nga donatorët</b>	<b>80%</b>	<b>60%</b>	<b>75%</b>	<b>Raporti financiar</b>	
	<b>Të hyrat nga programet kornizë</b>	<b>15%</b>	<b>25%</b>	<b>17%</b>	<b>Raporti financiar</b>	
	<b>Të hyrat nga fondet publike</b>	<b>3%</b>	<b>5%</b>	<b>4%</b>	<b>Raporti financiar</b>	
	<b>Sektori privat</b>	<b>2%</b>	<b>10%</b>	<b>4%</b>	<b>Raporti financiar</b>	
Objektivi 4. Brendim i së paku 2-3 produkteve.	Publikimi i raporteve të rregullta	ad hoc	4	3	Raportet e publikuara	-1 Raport nga Forumi Vjetor -2 Raporte x-index
	Funksionalizimi i platformës Quadruple Helix	-	1	2	Takimi konstituiv	Trupë joformale; Koncept dokumenti i është përcjellë ekipit të S3
	Riaktivizimi i platformave: Forumi 2015 Riinvest Debates dhe Green Talks	-	10	16	Raportet nga tryezat	
Objektivi 5. Ngritja e cilësisë së marrëdhënies me publikun, përmirësimi i komunikimit, rritja e prezencës në media.	<b>Pjesëmarrja në media</b>	<b>ad hoc</b>	<b>20</b>	<b>&gt;20</b>	<b>Evidentimi i paraqitjeve në media</b>	<b>-Kryesisht deklarata dhe intervista për media</b> <b>- 3 debate</b>
	<b>Numri i artikujve</b>	<b>ad hoc</b>	<b>20</b>	<b>5</b>	<b>Evidentimi i paraqitjeve në media</b>	
	Numri i ndjekësve në rrjetet sociale	~10,000 (Instituti Riinvest; GAS)	~20,000	~18,000	Raportet nga rrjetet sociale	
	Platforma avokuese Open 333	-	6	6	Raportet nga paraqitjet në platformën Open 333	-Ribrenduar në Green 333